



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregjeve, Tarifave dhe Shërbimit Postar
Sektori i Shërbimit Postar

Treguesit statistikorë dhe financiare të tregut të shërbimeve postare



Viti 2014

I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Operatori Publik Postar dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesorë të tregut postar për vitin 2014 të krahasuar me vitet e mëparëshme, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika”.

Për shkak të ruajtjes të konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga Operatori Publik dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare publikohen nga AKEP. Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore dhe financiare të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr. 28, datë 28.12.2012 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare” janë paraqitur të dhënat periodike statistikore dhe financiare të shërbimeve postare për vitin 2014 të dërguar nga Operatori Publik Postar – Posta Shqiptare sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të cilët janë pajisur nga AKEP me “Licencë të Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Licencë të Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare” te regjistruar në rregjistrin e AKEP deri në datën 31.12.2014 janë:

- **Operatori Publik Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (11 subjekte):**
 - DHL International Albania sh.p.k.
 - Albanian Courier sh.p.k. (A.C.)
 - Albanian Courier Service sh.p.k. (A.C.S.)
 - T.N.T Express Albania sh.p.k.
 - Sky Net Logistic sh.p.k.
 - RAD MAIL sh.p.k.
 - Ulysses Enterprises sh.p.k. (Fedex)
 - United Transport sh.p.k. (Uni Trans)
 - Youth Albania Professional Services (YAPS)
 - Albanian Delivery Express sh.p.k.
 - ORBIT Transport Courier Logistics & Removals sh.p.k.¹

Gjatë vitit 2014, përdorimi i teknologjive të reja ka sjellë një rritje të cilësisë së shërbimeve postare dhe të performancës së përgjithshme të operatorit publik dhe ofruesve të

¹ Albanian Delivery Express sh.p.k. dhe ORBIT Transport Courier Logistics & Removals sh.p.k., të cilët janë pajisur me licencë në vitin 2014, nuk kanë mundur të fillojnë ofrimin e shërbimeve postare gjatë vitit 2014

shërbimeve postare si dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për shërbimin postar dhe informatizimin e shërbimeve postare.

Ky zhvillim reflektohet në rritjen e volumit të shërbimeve postare për objektet postare të pranuar, të cilat janë pasqyruar në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm.

III. TË DHENA STATISTIKORE POSTARE

Të dhënat e dërguara dhe të trajtuara në këtë raport jepen për zërat kryesorë të shërbimeve postare.

Paraqitja e të dhënave jepet në mënyrë tabelare dhe grafike.

1. Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare

Gjatë vitit 2014 janë pranuar nga Posta Shqiptare sh.a dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare këto objekte postare:

Tabela 1.1: Volumi i objekteve postare në total të pranuar ne vitin 2014


Nr	Shërbime postare të ofruara	Objekte postare
I	Posta Shqiptare sh.a	
1	1. Shërbime bazë postare	
1.1	<i>Postë brenda vendit</i>	18.194.650
1.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	541.026
1.3	Totali (1.1 +1.2)	18.735.676
2	Dërgesa ekspres	
2.1	<i>Postë brenda vendit</i>	585.039
2.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	10.883
2.3	Totali (2.1 + 2.2)	595.922
2.4	Totali (1.3 + 2.3)	19.331.598
II	Ofrues të shërbimeve postare	
3	Dërgesa ekspres	
3.1	<i>Postë brenda vendit</i>	1.861.821
3.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	6.4806
3.3	Totali (3.1 + 3.2)	1.926627
4	Gjithsej (Totali 1.3 + 2.3 + 3.3)	21.258.225

2. Shërbimet bazë postare²

2.1 Posta Shqiptare – Shërbime bazë postare/postë brenda vendit


Në grafikët 2.1.1 dhe 2.1.2 më poshtë paraqiten të dhënat lidhur me numrin e objekteve të shërbimeve bazë postare brenda vendit të pranuar nga Operatori Publik Postar gjatë vitit 2014, si dhe të dhënat krahasimore të këtyre shërbimeve për periudhën 2012-2014. Nga krahasimi i të dhënave në vite rezulton se numri i objekteve postare për shërbimet bazë të postës brenda vendit gjatë vitit 2014 është rritur me rreth 28% krahasuar me vitin 2013.

Grafiku 2.1.1



Grafiku 2.1.2

Posta Shqiptare - Shërbime bazë postare/postë brenda vendit, 2012 – 2014




² Shërbim bazë postar kuptohet pranimit, përpunimit, vijimit dhe dorëzimit i objekteve të thjeshta të postës së letrave të adresuara, deri në 2 kg, i kolipostës së adresuar deri në 10 kg, shërbimi i urdhërpagesave postare dhe shërbimi për objektet e regjistruara dhe të siguruar. Për koliposten e adresuar ndërkombetare, që hyn nga shtete të tjera, kufiri i shërbimit bazë shtrihet deri në 20 kg.

2.2 Posta Shqiptare – Shërbime bazë postare/postë ndërkombëtare


Të dhënat statistikore vjetore për shërbimet bazë postare të postës ndërkombëtare të pranuar nga Operatori Publik Postar - Posta Shqiptare sh.a. gjatë vitit 2014, si dhe tabela krahasimore 2012-2014 paraqiten në grafikët më poshtë. Nga krahasimi i të dhënave në vite rezulton se numri i objekteve të realizuara në shërbimet bazë postare të postës ndërkombëtare në vitin 2014 është rritur me rreth 15% krahasuar me vitin 2013.

Grafiku 2.2.1

Posta Shqiptare - Shërbime bazë postare/postë ndërkombëtare
Viti 2014



Grafiku 2.2.2 Posta Shqiptare - Shërbime bazë postare/postë ndërkombëtare, 2012 – 2014



2.3 Posta Shqiptare – Shërbimi bazë postar kundrejt shërbimit ekspres

Sipas të dhënave të raportuara nga Posta Shqiptare sh.a për vitin 2014, shërbimi bazë postar me një numër prej 18,735,676 objektesh të pranuar zë 97% të totalit të objekteve postare, përkundrajt 3% që zë shërbimi ekspres me një numër prej 595,922 objekte postare të pranuar. Grafiku 1.3.1 e paraqet këtë situatë në formën e diagramës.

Grafiku 2.3.1.



3 Treguesit e shërbimeve ekspres³

3.1 Objekte postare të shërbimeve ekspres brenda vendit dhe ndërkombëtare

Nga tabela më poshtë rezulton se për sa i përket dërgesave ekspres brenda vendit, treguesit më të mirë i ka YAPS me një numër prej 1,233,306 objektesh postare të dërguara, e pasuar nga Posta Shqiptare sh.a. me 585,039 objekte postare të dërguara dhe Albanian Courier sh.p.k. me 405,110 objekte të dërguara me postë ekspres.


³ Shërbimi special i dorëzimit të objekteve postare të postës së shpejtë, brenda vendit - Posta Ekspres;
 - Shpërndarja e objekteve të paadresuara për publicitet;
 - Përgatitja e objekteve postare;
 - Shërbimi i përpunimit dhe transportit të objekteve postare të postës së jashtme.

Tabela 3.1.1 Objekte postare të shërbimeve ekspres brenda vendit dhe ndërkombëtare për vitin 2014

Emri i personit juridik/fizik	Dërgesa ekspres/ Postë brenda vendit	Dërgesa ekspres/ Postë ndërkombëtare
ALBANIAN COURIER	405110	3291
Albanian Courier Service	49620	0
DHL International Albania	18620	30690
Posta Shqiptare	585039	10883
RAD MAIL	140400	0
SKY NET LOGISTIC	0	1741
TNT EXPRESS ALBANIA	13465	1490
ULYSSES ENTERPRISES	1300	3600
UNITED TRANSPORT	0	23994
YAPS	1233306	0
Gjithësej	2,446,860	75,689

Nga krahasimi i numrit të objekteve postare të realizuar në shërbimet ekspres brenda vendit dhe atyre ndërkombëtare në total për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të marra së bashku gjatë periudhës 2012-2014, rezulton se numri i dergesave ekspres brenda vendit gjatë vitit 2014 është rritur me 19.8% krahasuar me vitin 2013, ndërsa numri i dergesave ekspres ndërkombëtare është rritur me 10.3% krahasuar me vitin 2013.

Grafiku 3.1.2 Numri i shërbimeve ekspres, brenda vendit/ndërkombëtare 2012-2014




4. Tregu sipas volumit të objekteve postare 2012-2014

Për sa i përket objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2014 nga Posta Shqiptare sh.a dhe Ofruesit e Sherbimeve Postare të marra së bashku, rezulton se objektet postare të pranuar gjatë vitit 2014 janë rritur me **21.3%** në krahasim me vitin 2013.

Posta Shqiptare zë **90.9%** pjesë tregu përkundrejt Ofruesve të Shërbimeve Postare të cilët së bashku zënë **9.1%** pjesë tregu.

Grafiku 4.1 Ecuria e pjesëve të tregut sipas volumit të objekteve postare 2012-2014



5. Treguesit teknik dhe të rrjetit

Posta Shqiptare e cila ofron shërbim në të gjithë vendin në **553** zyra të hapura për publikun ka treguesit më të mirë të rrjetit, e ndjekur nga United Transport, Albania Courier, Albanian Courier Service, TNT Express Albania dhe DHL International Albania. Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit bazë **622** sportele nga të cilët **327** sportele janë të automatizuar/kompjuterizuar.

Në përgjithësi prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Posta Shqiptare sh.a., është në qytetet kryesore të vendit.

Përsa i përket infrastrukturës së mjeteve postare Posta Shqiptare ka në përdorim 426 automjete transporti, Albanian Courier 46, TNT Express 27, RAD MAIL 21, DHL International 11, të pasuar nga Ofruesit e tjerë.

Tabela 5.1 Treguesit teknik dhe të rrjetit postar

Emri i personit (juridik/fizik)	Zyra postare të hapura për publikun	Zyra postare jo të hapura për publikun	Numri i sporteleve për shërbime universale	Numri i automjeteve të transportit
Albanian Courier	103	1	0	46
Albanian Courier Service	99	1	0	2
DHL International Albania	22	1	0	11
Posta Shqiptare	553	17	622	426
RAD MAIL	1	0	0	21
SKY NET Albania	2	0	0	2
TNT Express Albania	32	0	0	27
Ulysses Enterprises	13	1	0	6
United Transport	102	1	0	4
YAPS	1	1	0	8
Totali për 2014	928	23	622	553
Totali për 2013	1278	34	622	593
Totali për 2012	839	21	610	593

6. Cilësia dhe standardet e realizimit të shërbimeve postare

Treguesit për numrin e dërgesave ekspres sipas kohës së dorëzimit:

- Dorëzuar D+1;
- Dorëzuar D+2;
- Dorëzuar D+3;
- Dorëzuar D+4;
- Dorëzuar D>4.


Shënim: (D+n) D - dita e pranimit të dërgesave ; n (1,2,3,4) - ditët brenda të cilave janë dorëzuar/shpërndarë dërgesat.

Në mënyrë tabelare dhe grafike paraqiten treguesit cilësorë për sa i përket kohës së dorëzimit të dërgesave postare.

Tabela 6.1 Koha e dorëzimit të objekteve postare 2012-2014

Emri i personit (juridik/fizik)	D+1	D+2	D+3	D+4	D>4
ALBANIAN COURIER	405110	10179	0	0	0
Albanian Courier Service	49620	0	0	0	0
DHL International Albania	107791	4093	696	260	347
Posta Shqiptare	18613853	674549	28106	9369	0
RAD MAIL	84240	28080	14040	14040	0
SKY NET LOGISTIC	1015	360	160	91	115
TNT EXPRESS ALBANIA	12655	1680	620	0	0
ULYSSES ENTERPRISES	1200	1300	650	450	0
UNITED TRANSPORT	11762	11232	0	0	0
YAPS	10544	0	0	48490	1174272

Grafiku 6.2



Nga të dhënat e paraqitura në tabela 6.1 për Vitin 2014 rezultojnë:

D+1 - Janë dorëzuar/shpërndarë 91 % e objekteve postare;

D+2 - Janë dorëzuar/shpërndarë 3.4% e objekteve postare;

D+3 - Janë dorëzuar/shpërndarë 0.2% e objekteve postare;

D+4 - Janë dorëzuar/shpërndarë 0,3% e objekteve postare;

D>4 - Janë dorëzuar/shpërndarë 5,5% e objekteve postare.

Në bazë të grafikut 6.2, duke krahasuar të dhënat lidhur me cilësinë e shpërndarjes së objekteve postare, gjatë vitit 2014 rezultojnë një rritje prej 23.7% të numrit të objekteve të dorëzuara/shpërndara në D+1.

7. Rezultatet Financiare – 2014


Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2014 nga operatori publik dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë 2,986,218,654 Lekë. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 2,037,596,000 Lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2014.

Posta Shqiptare zotëron 68 % të tregut, e pasuar nga DHL Albania me 13 % të tregut dhe më pas nga TNT Express Albania me 6 %, Albanian Courier me 5 %, United Transport me 3 %.


Siç mund të vihet re nga grafiku, të ardhurat nga shërbimet postare për vitin 2014 janë rritur me 10 % në krahasim me vitin 2013.

Emri i personit Juridik	Totali i të ardhurave
ALBANIAN COURIER	150,784,717
Albanian Courier Service	4,479,895
DHL International Albania	402,552,406
Posta Shqiptare	2,037,596,000
RAD MAIL	58,362,089
SKY NET LOGISTIC	12,805,409
TNT EXPRESS ALBANIA	164,016,920
ULYSSES ENTERPRISES	33,581,730
UNITED TRANSPORT	77,481,490
YAPS	44,557,998

Grafiku 7.1. Pjesët e tregut në të ardhura - 2014



Grafiku 7.2. Ecuria e të ardhurave të sektorit gjatë periudhës 2012-2014




8. Investimet

Gjatë vitit 2014, në sektorin postar janë realizuar investime në vlerën 141,184,903 Lekë, ose 2.4 herë më shumë se në vitin 2013.

Në figurën më poshtë paraqitet në formë të detajuar realizimi i investimeve në tregun postar për vitin 2014, si dhe ecuria e këtij treguesi krahasuar me vitet paraardhëse.


Grafiku 8.1. Totali i investimeve në sektorin postar gjatë periudhës 2012-2014





9. Të punësuarit

Në sektorin postar rezultojnë gjithsej 2,513 të punësuar, nga të cilët 2,451 punonjës janë të punësuar me kohë të plotë dhe 62 punonjës me kohë të pjesëshme.

Grafiku 9.1 Të punësuarit – Viti 2014



Grafiku 9.2 Të punësuarit 2012-2014



10. Ankesat e Përdoruesve (Reklamacionet)


Sipas të dhënave të dërguara, gjatë vitit 2014 pranë Posta Shqiptare sh.a janë depozituar 1005 reklamacione nga të cilat janë zgjidhur 730, pranë DHL janë depozituar 49 reklamacione nga të cilat janë zgjidhur 49, TNT Express Albania ka regjistruar 11 reklamacione, nga të cilat ka zgjidhur 11, Ulysess Enterprises ka regjistruar 7 nga të cilat ka zgjidhur 7 reklamacione, ndërsa United Transport ka pranuar 4 reklamacione të cilat janë zgjidhur.

Tabela 10.1 Reklamacionet

Emri i personit (juridik/fizik)	Të pranuar	Të zgjidhura
Albanian Courier	0	0
Albanian Courier Service	0	0
DHL Albania	49	49
Posta Shqiptare	1005	730
RAD MAIL	0	0
SKY NET LOGISTIC	0	0
TNT Express Albania	11	11
Ulysess Enterprises	7	7
United Transport	4	4
YAPS	0	0
Totali	1076	801

Nga krahasimi i Ankesave (Reklamacioneve), gjatë vitit 2014 vërehet një rënie me 5.7% të ankesave të pranuar nga operatori publik dhe ofruesit e shërbimeve postare. Ndërsa duke bërë një krahasim të ankesave të zgjidhura, në raport me ato të pranuar sipas viteve vërehet se gjatë vitit 2012 janë zgjidhur 85% e ankesave, gjatë vitit 2013 janë zgjidhur 91% të ankesave, ndërsa gjatë vitit 2014 janë zgjidhur rreth 75% e ankesave.

Grafiku 10.2 Tabela krahasimore – Reklamacionet 2012 – 2014



11. Tregues të rëndësishëm

Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare për vitin 2014, disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve postare, në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë:

➤ **Tregues për shërbimin bazë postar të realizuar nga Posta Shqiptare:**

- Objekte postare të pranuar nga Posta Shqiptare për shërbimet bazë postare 18.735.676 në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.821.977 janë: **6.6 objekte / banorë.**
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 553, për ofrimin e shërbimeve bazë postare nga Posta Shqiptare në raport me popullsinë 2.821.977 janë: **5.103 banorë / zyrë.**
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 553, për ofrimin e shërbimeve bazë postare nga Posta Shqiptare në raport me sipërfaqen 28.748 Km² janë: **52 Km² / zyrë.**

➤ **Tregues të realizuar nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare:**

- Objekte postare të pranuar gjithësej 21.258.225 në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.821.977 janë: **7.5 objekte / banorë.**
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 928 në raport me popullsinë 2.821.977 janë: **3.040 banorë / zyrë.**
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 928 në raport me sipërfaqen 28.748 Km² janë: **31 Km² / zyrë .**